

Data 24.01.2025

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “BLERJE KARBURANT” ndare ne lote si meposhte:

Loti 1: Blerje gazoil 10 ppm ULSD,

Loti 2: Blerje benzinë Premium Unl 10ppm

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Naftë 09134000-7

Benzinë 09132000-3

**VLERA E FONDIT LIMIT: 210,133,139** (dyqind e dhjetë milion e njëqind e tridhjet e tre mijë e njëqind e tridhjet e nëntë) lekë pa tvsh i ndarë në lote si mëposhtë vijon:

**Loti 1: Blerje gazoil 10 ppm ULSD** me fond limit **196,383,139** (njëqind e nëntëdhjet e gjashtë milion e treqind e tetëdhjet e tre mijë e njëqind e tridhjet e nëntë) Lekë pa TVSH.

**Loti 2: Blerje benzinë Premium Unl 10 ppm** me fond limit **13,750,000** (trembëdhjet milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 2,138,106.8 (një milion e njëqind e tridhjet e tetë mijë e njëqind e gjashtë pikë tetë) euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 23.01.2025 është 98.28 lekë.

**Loti 1: Blerje gazoil 10 ppm ULSD** vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 1,998,200.4 (një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e dyqind pikë katër) euro pa tvsh.

**Loti 2: Blerje benzinë Premium Unl 10 ppm** vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 139,906.3 (njëqind e tridhjet e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtë mijë pikë tre) euro pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

### **Loti 1: Blerje gazoil 10 ppm ULSD**

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, 34, 35, 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

1.Çertifikatë **ISO 9001-2015 ose ekuivalent** (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

*Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së .*

2.Çertifikatë **ISO 14001-2015 ose ekuivalent** (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Kjo certifikatë është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të mjedisit. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo certifikatë ofron një kuadër praktik për shoqëritë që menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Është pranuar në mbarë botën se burimet e botës sonë, që po pakësohen nga dita në ditë, nuk janë të pafundme dhe se ndikimet mjedisore të produkteve dhe aktiviteteve nuk janë lokale dhe rajonale por globale. Ky ndërgjegjësim ka sjellë nevojën për të kontrolluar ndikimet mjedisore. Të qenit i pranishëm në tregun lokal dhe atë global, tani po matet me respekt dhe respekt që u jepet njerëzve. Përveç përmbushjes së pritshmërive dhe nevojave të konsumatorëve të sotëm në nivelin më të lartë, kërkohet që të vlerësohet dhe respektohet mjedisi dhe bota në të cilën jetojmë.

Këto zhvillime kanë zbuluar faktin se ekziston një nevojë për sisteme menaxheriale që do t'u mundësojnë bizneseve të mbajnë nën kontroll ndërveprimet e tyre me mjedisin dhe të përmirësojnë vazhdimisht aktivitetet dhe arritjet e tyre mjedisore. ISO 14001 është një standard i sistemit, i cili bazohet në monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës mjedisore. Ajo është në përputhje me kushtet e përcaktuara nga legjislacioni përkatës dhe ligjet në lidhje me faktorët e mjedisit. Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit quhet Sistemi i menaxhimit që çdo kompani zhvillon për reduktimin sistematik dhe eliminimin e mundshëm të dëmeve që ato mund të shkaktojnë në mjedis. Pra si rezultat i këtij gjykimi menaxhimi i mjedisit që ka lidhje me certifikatën ISO 14001:2015 është standart me të cilin **duhet të operojë çdo kompani pavarësisht fushës së saj të aktivitetit apo madhësisë së saj**. Ky standart tregon se kompania gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj operon në përputhje me parimet e mbrojtjes së ekosistemit dhe minimizimin e efekteve negative në mjedis.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencën përkatëse për tregtimin me pakicë të karburanteve, sipas objektit të prokurimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenit 40, pika 5, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"; në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 "Për praktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj".

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit/shumës së loteve për të cilët konkurron. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Autoriteti Kontraktor i është referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 43, pika 2, gërma b) dhe vlerën e xhiros minimale vjetore e ka përcaktuar brenda kufirit maksimal të lejuar nga ky nen.

---

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021,2022,2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor,organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

- 1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e fondit limit të lotit/shumës së loteve për të cilët konkuron.  
Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:
  - a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
  - b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara., ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 40 % e fondit limit të lotit/shumës së loteve për të cilët konkuron, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

**2.** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë, minimumi 7 (shtatë) në territorin e Bashkisë Tiranë, vërtetuar me një

nga format e disponimit sipas Kodit Civil (akt pronësie ose qeraje, të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB ose kontratë bashkepunimi noteriale për gjithë kohëzgjatjen e marrëveshjes kuadër etj). Këto stacione të jenë të pajisura me leje mjedisore sipas legjislacionit në fuqi të lëshuar nga QKL, Vërtetim teknik lëshuar nga ISHTI ose nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), Akt teknik lëshuar nga PMNZH dhe policë sigurimi lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kapacitet për të përmbushur kontratën.

**3. Dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.**

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Autobot me kapacitet mbajtës minimumi 1000 litra	2	Pronësi ose me qira

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik; ç) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); d) certifikatën për transportin e lëndëve të rrezikshme, dh) pasaportën e mjetit për kapacitetin mbajtës në litra.*
- Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik; ç) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); d) certifikatën për transportin e lëndëve të rrezikshme, dh) pasaportën e mjetit për kapacitetin mbajtës në litra. Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.*
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- Autobotet duhet të jenë të pajisur me kontratë nga DPM dhe të regjistruar në Ekstraktin e QKB-së së operatorit ekonomik.*
- Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Autoriteti Kontraktor ushtron një veprimtari të gjerë në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, ku përfshihen jo vetëm zonat urbane por edhe të gjitha territoret e ish-komunave, pra zonat rurale. Objekti i veprimtarisë së Autoritetit Kontraktor përfshin mirëmbajtjen e rrugëve urbane dhe rurale, e rrjetit të ndriçimit publik, e sinjalistikës rrugore (vertikale dhe horizontale, me apo pa ndriçim) si dhe mirëmbajtjen e kanaleve kulluese dhe vaditëse në territorin e Bashkisë Tiranë.

Në funksion të realizimit me sukses të detyrave të tij, Autoriteti Kontraktor disponon një flotë prej rreth 86 mjetesh, tipologjia dhe larmia e të cilave varion që nga kamionçinat, kamion me

akse të ndryshme, transportier rimorkio, fadroma, ekskavator me goma dhe me zinxhir, rula, autokulla, frezë asfalti, shtruese asfalti etj.

Disa nga mjetet e Autoritetit janë mjete teknologjike të tonazhit të rëndë, të cilat stacionohen në kantiere pune që ndodhen në zona rurale të ndryshme dhe kryejnë procese pune të vazhdueshme siç është pastrimi i kanaleve kulluese dhe vaditëse, heqja e dherave nga rrëshkitjet etj. dhe për këtë arsye e kanë të pamundur furnizimin me karburant në stacionet e furnizimit për shkak të largësisë së tyre. Përveç largësisë nga pikat e furnizimit, lëvizja dhe transporti (eskavatorët me zinxhir transportohen vetem me rimorkiator) i këtyre mjeteve nga kantieri drejt këtyre pikave do të sillte humbje në kohë dhe kosto për Autoritetin Kontraktor.

Mjetet kryesore teknologjike që disponon Autoriteti, të cilat kanë nevojë të furnizohen me autobot janë:

-Eskavator me zinxhir (Volvo), rreth 24 ton, me kapacitet të depozitës së karburantit rreth 350 litra.

-Eskavator me zinxhir (Volvo), rreth 10 ton, me kapacitet të depozitës së karburantit rreth 100 litra.

(Be-Eskavator me goma (Terex), rreth 18 ton, me kapacitet të depozitës së karburantit rreth 250 litra.

-Eskavator me goma nati), rreth 12.5 ton, me kapacitet të depozitës së karburantit rreth 250 litra.

Nga një përlllogaritje e përafërt rezulton që sasia e karburantit për furnizimin e mjeteve të mësipërme varion rreth 1000 litra.

Në këto kushte dhe përsa u argumentua më lart, Autoritetit Kontraktor gjykon se kjo kërkesë për furnizim me autobot me kapacitet mbajtës minimumi 1000 litra është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit.

4.Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë fletë/raport analizë të lëshuar nga një laborator i çertifikuar në Republikën e Shqipërisë, për lëndën djegëse Gazoil 10 ppm ULSD, sipas specifikimeve teknike. Fletë/raport analiza duhet të jetë lëshuar brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hapjes së ofertave.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 6/c e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

5.Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që subjekti ofertues ka tregëtuar mallin objekt prokurimi, sipas standarteve të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin 2024.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 7/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se e ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kapacitet për të përmbushur kontratën.

Autoriteti Kontraktor ushtron një veprimtari të gjerë në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, ku përfshihen jo vetëm zonat urbane por edhe të gjitha territoret e ish –komunave, pra zonat rurale. Objekti i veprimtarisë së Autoritetit Kontraktor përfshin mirëmbajtjen e rrugëve urbane dhe rurale, e rrjetit të ndriçimit publik, e sinjalistikës rrugore (vertikale dhe horizontale, me apo pa ndriçim) si dhe mirëmbajtjen e kanaleve kulluese dhe vaditëse në territorin e Bashkisë Tiranë. Në funksion të realizimit me sukses të detyrave të tij, Autoriteti Kontraktor disponon një flotë prej rreth 86 mjetesh, tipologjia dhe larmia e të cilave varion që nga kamionçinat, kamion me akse të ndryshme, transportier rimorkio, fadroma, ekskavator me goma dhe me zinxhir, rula, autokulla, frezë asfalti, shtruese asfalti etj. Duke marrë në konsideratë territorin e gjerë ku operohet dhe dinamikën e punimeve që kryhen është i domosdoshem aksesimi në pika të shumta karburanti duke shmangur humbjen në kohë dhe koston që do të sillte për Autoritetin Kontraktor mungesa e aksesit nga pikat e furnizimit. Në këto kushte dhe përsa u argumentua më lart, AK gjykon se kjo kërkesë është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit.

**6. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se:**

- a) Merr përsipër furnizimin gjatë 24 orëve, në stacionet e tij të shitjes së karburanteve me pakicë, me pistoletë publike për çdo mjet të AK, të pajisur me kartë elektronike të personalizuar.
- b) Merr përsipër furnizimin me bot, me shpenzimet e tij, në shërbim 24 orë në vendin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.
- c) Merr përsipër të ofrojë, në zbatim të VKM-së Nr. 561, datë 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” një faqe menaxhimi të karburanteve (ëebpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike. Faqja e menaxhimit të karburanteve (ëebpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targon e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti Kontraktor. Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara më sipër në mënyrë elektronike nëpërmjet faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës përbën kusht për s’kualifikim.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 8 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponueshmërinë e tyre për furnizimin me karburant në vendet e përcaktuara nga AK sipas kërkesave të tij në funksion të mbarëvajtjes së proceseve të punës si dhe furnizimin në stacionet e shitjes së karburanteve me pakicë, me pistoletë publike.



## **Loti 2: Blerje benzinë Premium Unl 10ppm**

### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

1.Çertifikatë **ISO 9001-2015 ose ekuivalent** (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së .*

2.Çertifikatë **ISO 14001-2015 ose ekuivalent** (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kjo certifikatë është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të mjedisit. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo certifikatë*

*ofron një kuadër praktik për shoqëritë që menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Është pranuar në mbarë botën se burimet e botës sonë, që po pakësohen nga dita në ditë, nuk janë të pafundme dhe se ndikimet mjedisore të produkteve dhe aktiviteteve nuk janë lokale dhe rajonale por globale. Ky ndërjegjësim ka sjellë nevojën për të kontrolluar ndikimet mjedisore. Të qenit i pranishëm në tregun lokal dhe atë global, tani po matet me respekt dhe respekt që u jepet njerëzve. Përveç përmbushjes së pritshmërive dhe nevojave të konsumatorëve të sotëm në nivelin më të lartë, kërkohet që të vlerësohet dhe respektohet mjedisi dhe bota në të cilën jetojmë.*

*Këto zhvillime kanë zbuluar faktin se ekziston një nevojë për sisteme menaxheriale që do t'u mundësojnë bizneseve të mbajnë nën kontroll ndërveprimet e tyre me mjedisin dhe të përmirësojnë vazhdimisht aktivitetet dhe arritjet e tyre mjedisore. ISO 14001 është një standard i sistemit, i cili bazohet në monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës mjedisore. Ajo është në përputhje me kushtet e përcaktuara nga legjislacioni përkatës dhe ligjet në lidhje me faktorët e mjedisit. Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit quhet Sistemi i menaxhimit që çdo kompani zhvillon për reduktimin sistematik dhe eliminimin e mundshëm të dëmeve që ato mund të shkaktojnë në mjedis. Pra si rezultat i këtij gjykimi menaxhimi i mjedisit që ka lidhje me çertifikatën ISO 14001:2015 është standart me të cilin **duhet të operojë çdo kompani pavarësisht fushës së saj të aktivitetit apo madhësisë së saj**. Ky standart tregon se kompania gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj operon në përputhje me parimet e mbrojtjes së ekosistemit dhe minimizimin e efekteve negative në mjedis.*

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencën përkatëse për tregtimin me pakicë të karburanteve, sipas objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 ”Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 ”Për praktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie të licencave për tregtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit/shumës së loteve për të cilët konkurron. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Autoriteti Kontraktor i është referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, pika 2, gërma c) dhe vlerën e xhiros minimale vjetore e ka përcaktuar brenda kufirit maksimal të lejuar nga ky nen.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021,2022,2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor,organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e fondit limit të lotit/shumës së loteve për të cilët konkuron.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

*Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 40 % e fondit limit të lotit/shumës së loteve për të cilët konkurron, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

2.Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë, minimumi 7 (shtatë) në territorin e Bashkisë Tiranë, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (akt pronësie ose qeraje, të pasqyruara në ekstraktin e rregjistrimit tregtar lëshuar nga QKB ose kontratë bashkepunimi noteriale për gjithë kohëzgjatjen e marrëveshjes kuadër etj). Këto stacione të jenë të pajisura me leje mjedisore sipas legjislacionit në fuqi të lëshuar nga QKL, Vërtetim teknik lëshuar nga ISHTI ose nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), Akt teknik lëshuar nga PMNZH dhe policë sigurimi lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri.

*Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kapacitet për të përmbushur kontratën.*

*Autoriteti Kontraktor ushtron një veprimtari të gjerë në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, ku përfshihen jo vetëm zonat urbane por edhe të gjitha territoret e ish –komunave, pra zonat rurale. Objekti i veprimtarisë së Autoritetit Kontraktor përfshin mirëmbajtjen e rrugëve urbane dhe rurale, e rrjetit të ndriçimit publik, e sinjalistikës rrugore (vertikale dhe horizontale, me apo pa ndriçim) si dhe mirëmbajtjen e kanaleve kulluese dhe vaditëse në territorin e Bashkisë Tiranë. Në funksion të realizimit me sukses të detyrave të tij, Autoriteti Kontraktor disponon një flotë prej rreth 70 mjedesh, tipologjia dhe larmia e të cilave varion që nga kamionçinat, kamion me akse të ndryshme, transportier rimorkio, fadroma, ekskavator me goma dhe me zinxhir, rula, autokulla, frezë asfalti, shtruese asfalti etj. Duke marrë në konsideratë territorin e gjerë ku operohet dhe dinamikën e punimeve që kryhen është i domosdoshem aksesimi në pika të shumta karburanti duke shmangur humbjen në kohë dhe koston që do të sillte për Autoritetin Kontraktor mungesa e aksesit nga pikat e furnizimit. Në këto kushte dhe përsa u argumentua më lart, AK gjykon se kjo kërkesë është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit.*

3. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë fletë/raport analizë të lëshuar nga një laborator i certifikuar në Republikën e Shqipërisë për lëndë djegëse benzinë, sipas specifikimeve teknike. Fletë/raport analiza duhet të jetë lëshuar brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hapjes së ofertave.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 6/c e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që subjekti ofertues ka tregëtuar mallin objekt prokurimi, sipas standarteve të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin 2024.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 7/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se e ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

5. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se:

- a) Merr përsipër furnizimin gjatë 24 orëve, në stacionet e tij të shitjes së karburanteve me pakicë, me pistoletë publike për çdo mjet të AK, të pajisur me kartë elektronike të personalizuar.
- b) Merr përsipër të ofrojë, në zbatim të VKM-së Nr. 561, datë 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” një faqe menaxhimi të karburanteve (ëebpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike. Faqja e menaxhimit të karburanteve (ëebpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targa të mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti Kontraktor. Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara më sipër në mënyrë elektronike nëpërmjet faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës përbën kusht për s’kualifikim.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 8 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponueshmërinë e tyre për furnizimin në stacionet e shitjes së karburanteve me pakicë, me pistoletë publike.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm, i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve të teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **Specifikimet teknike:**

#### **LOTI 1: Blerje gazoil 10 ppm ULSD**

Gazoil 10 ppm ULSD duhet të jetë në përputhje me standartin S SH EN 590: 2013+A1:2017 sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, që është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri.

#### **LOTI 2: Blerje benzinë**

Benzina (Premium Unl 10 ppm) duhet të jetë në përputhje me standartin S SH EN 228:2012 + A1:2017, sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, që është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri.

### **Argumentimi:**

Autoriteti Kontraktor ushtron një veprimtari të gjerë në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, ku përfshihen jo vetëm zonat urbane por edhe të gjitha territoret e ish –komunave, pra zonat rurale. Objekti i veprimtarisë së Autoritetit Kontraktor përfshin mirëmbajtjen e rrugëve urbane dhe rurale, e rrjetit të ndriçimit publik, e sinjalistikës rrugore (vertikale dhe horizontale, me apo pa ndriçim) si dhe mirëmbajtjen e kanaleve kulluese dhe vaditëse në territorin e Bashkisë Tiranë. Në funksion të realizimit me sukses të detyrave të tij, Autoriteti Kontraktor disponon një flotë prej rreth 80 mjedesh, tipologjia dhe larmia e të cilave varion që nga kamionçinat, kamion me akse të ndryshme, transportier rimorkio, fadroma, ekskavator me goma dhe me zinxhir, rula, autokulla, frezë asfalti, shtruese asfalti etj.

Specifikimet teknike të lendeve djegese, objekt prokurimi janë përcaktuar referuar kërkesave dhe tipologjisë së automjeteve sipas standarteve të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit ose ekuivalente, si organizmi kombëtar i standartizimit në Republikën e Shqipërisë për hartimin, adoptimin, miratimin dhe publikimin e standardeve në të gjithë sektorët e ekonomisë në zbatim të ligjit nr.9870, datë 04.02.2008 “Për standartizimin”, i ndryshuar.

*Shënim: Për çdo standart ose emërtim marke të përmendur pranohet edhe ekuivalenti i tyre.*

*Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 6 të Dokumentave Standarte të Tenderit.*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

## **NJËSIA E PROKURIMIT**